



Bordi

### **VENDIM**

**Nr. 12, Datë 29.01.2016**

#### **MBI**

### **ANKANDET E KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT NË KUFIRIN ME KOSOVËN**

Në mbështetje të neneve 16 , 18 dhe 19 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 111, 112 dhe 127 të “Kodit të Procedurave Administrative”, Nenit 3 pika 1, gërma d dhe 16 te “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE” miratuar me vendimin nr.21 date 18.03.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE, i ndryshuar, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 29.01.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë teknike, mbasi shqyrtoi kërkesën e OST sh.a. në lidhje me alokimin e kapaciteteve në kufirin me Kosovën,

#### **Konstatohet se:**

- Rregullat e ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore (SEE CAO) nuk mund të aplikohen me vende kufitare të cilat nuk i kanë kapacitetet të alokuara në SEE CAO.
- Kufiri Shqipëri–Kosovë nuk është përfshirë në ankandin vjetor të kapaciteteve të interkonjeksionit të zhvilluar nga SEE CAO për shkak të paqartësisë së funksionimit të KOSTT si zonë e pavarur rregulluese e njohur nga ana e ENTSO-ve. Kjo gjë evidentohet edhe në faqen zyrtare të SEE CAO.
- Me shkresën Nr prot 587/1 të datës 29.01.2016 OST sh.a. ka depozituar në Entin Rregullator të Energjisë kërkesën për miratimin nga Bordi i Anëtarëve të ERE, të një rregulli përjashtues, i cili të paraprijë e shmangë problematikat në zhvillimin e ankandëve të interkonjeksionit në kufirin me Kosovën,

që mund të zhvillohen edhe në të ardhmen nëse status quo e Kosovës nuk ndryshon.

- ERE, ndodhet në kushtet e detyrimit për t'u shprehur me një vendim rregullues, në lidhje me rrethanat e parashikuara në problematikat e parashtruara nga OST sh.a dhe të njohura publikisht edhe nëpërmjet faqes zyrtare të SEE CAO, rrethana të cilat nëse pushojnë se ekzistuari, shterojnë edhe fuqinë juridike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

#### Vendosi:

1. Për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit në kufirin me Kosovën, OST sh.a, do të zbatojë Vendimin Nr. 140, datë 22.11.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për *miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit*”, i ndryshuar.
2. Ky vendim shteron fuqinë e tij juridike me ndryshimin e rrethanave që çuan në miratimin e tij.
3. OST sh.a. ka detyrimin për njoftimin e ndryshimit të këtyre rrethanave në ERE.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për të njoftuar të licencuarin OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet juridike nga data 1 janar 2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

---

Adresa: Blvd “Gjergj Fishta” Nr.10  
Tirane  
E-mail [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al)

Tel/Fax +355 42 22 963  
Tel +355 42 69 590  
[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)